



Republika e Kosovës
Republika Kosova/Republic of Kosovo
Kuvendi Komunal Dragash/Skupština Opštine Dragash/Dragas Municipality

- Kuvendi Komunal
01 Nr.006-126/12-1
Dt.22.02.2012
D r a g a s h

Kuvendi Komunal i Dragashit, në seancën e dt.22.02.2012, sipas Kërkesës së MAPL-it, bënë rishqyrtimin e Vendimit të dt.07.07.2011, në bazë të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40, përkatësisht nenit 14.1, 14.2 dhe nenit 17 të këtij Ligji, miratohet ky:

V E N D I M

- I. **JEPET PËLQIMI** për realizimin e investimeve në hidrocentrale të lumit Brod dhe Restelicë, sipas Kërkesës dhe Projektit Ideor për këtë çështje të Konzorciumit “Eurokos JH & Loreto Consult AG”,
- II. Pëlqimi për shfrytëzimin e pronës komunale jepet duke u mbështetur në procedurat ligjore, ku është parapar ndërtimi i hidrocentrale sipas studjimeve të Konzorciumit, kurse kompenzimi i pronës së parapar për eksproprim bëhet sipas dispozitave ligjore në fuqi.
- III. Pas marrjes së Liçencës nga ZREnergjisë, autorizohet drejtori i Drejtoratit të Ekonomisë, Financave dhe Zhvillim i Komunës-Dragash që të rregulloj çështjen e taksave për pronën shoqërore konform dispozitave ligjore në fuqi.
- IV. Pas miratimit të këtij Vendimi, obligohet Konzorciumi që të vazhdon procedurat e mëtejme ligjore, të cilat, pas dorëzimit të projekteve kryesore do të janë bazë për dhënien e Lejes së Ndërtimit nga Drejtorati për Urbanizëm, Gjeodezi dhe Kadastër i Komunës-Dragash, përfshi këtu edhe marrjen e pëlqimeve tjera të kërkuara nga Konzorciumi që obligohet t’i jep Kuvendi Komunal i Dragashit për realizimin e investimeve.
- V. Për rrjedhat e mëtejme reth realizimit të projekteve të parapara, sipas Kërkesës, të njoftohet Kuvendi Komunal i Dragashit.
- VI. Ky Vendim hynë në fuqi nga dita e miratimit.

A r s y e t i m

Duke u bazuar në Kërkesën e MAPL-it për rishqyrtimin e Vendimit të KK-së Dragash të dt. 07.07.2011, si dhe duke e pasur parasysh rëndësinë ekonomiko-zhvillimore, shfrytëzimin e resurseve natyrore të lumenjëve dhe ruajtjen e ambientit të Komunës, si dhe nevojën për shfrytëzimin të energjisë nga rrjedha e lumenjëve të Komunës së Dragashit, në seancën e dt.22.02.2012, miratohet Vendimi për dhënien e Pëlqimit si në dispozitiv të pikës I të këtij Vendimi.

I dërgohet :

- Drejtoratit për Urbanizëm, Gjeodezi dhe Katastër-Dragash, drejtorit Bean Haxhihasan,
- Drejtoratit për Ekonomi, Financa e Zhvillim-Dragash, drejtorit Ahmet Bahtijari,
- Firmës-Konzorciumit “Eurokos JH & Loreto Consult AG “ Zug-Zvicërr, drejtorit Ylli Shamolli-Prishtinë, dhe
- Arkivit

KUVENDI KOMUNAL-DRAGASH
Kryesuesi
Lulzim Rifaj

